

Ngjitës pllakash fleksibël, shumë i lehtë, i modifikuar me polimer për sipërfaqet shumë të vështira

Përshkrimi

ISOMAT AK-LIGHT është një ngjitës pllakash me bazë çimentoje i cilësisë së lartë, shumë i lehtë dhe i modifikuar me polimer. Për shkak të peshës të lehtë, ngjitja e pllakave është shumë e thjeshtë dhe sasia e nevojshme është më e vogël sesa një ngjitës me materiale inerte të zakonshme. Ofron një forcë ngjitime fillestare dhe përfundimtare të lartë, si dhe rezistencë ndaj lagështisë dhe elasticitet. Klasifikohet si absolutisht pa rrëshqitje (asnjë rrëshqitje e pllakës) dhe ka kohë të mëdha për mbajtjen hapur.

Klasifikohet si ngjitës e llojit C2 TE S1 sipas standardit EN 12004 dhe EN 12002.

Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-LIGHT përshtatet për ngjitjen e pllakave me thithshmëri ose pa thithshmëri (p.sh. pllakat "gres porcelanato"), gurit natyral, tullave dekorative, pllakave të mëdha, pllakave mozaik pre xhami etj. në mure ose dysheme, mbi sipërfaqe të ndryshme, dhe në veçanti aty ku kërkohet aftësi e lartë ngjitime, elasticitet dhe rezistencë e lartë ndaj lagështisë (p.sh. shtresat e vjetra të pllakave, dyshemetë me ngrohje nga poshtë, sipërfaqet metalike, pishinat, pllakat e gipsit etj.). Përshtatet për përdorim në mjedise të brendshme ose të jashtme.

Të dhënat teknike

Trajta:	Ilaç çimentoje
Ngjyra:	e bardhë
Uji që nevojitet:	8,10 kg për një thes 18 kg
Temperatura e përdorimit: nga +5°C deri në +35°C	
Trashësia e përdorimit:	deri në 15 mm
Koha e punueshmërisë:	të paktën 6 orë

Koha e mbajtjes hapur: të paktën 30 minuta

Koha e mbajtjes hapur për riparime të vogla: të paktën 30 minuta

Rrëshqitja: ≤ 0,5 mm

Stukimi i fugave në mure: pas 3-8 orësh

Stukimi i fugave në dysheme: pas 24 orësh

Forca ngjitime pas:

- 28 ditësh: ≥ 1,90 N/mm²
- ngrohjes në +70°C: ≥ 1,90 N/mm²
- zhytjes në ujë: ≥ 1,50 N/mm²
- 25 ciklesh ngrirje-shkrirje: ≥ 1,50 N/mm²

Rezistenca ndaj temperaturave:
nga -30°C deri në +90°C

Aftësia e deformimit

sipas standardit EN 12002: > 2,5 mm

Të gjitha matjet janë kryer sipas standardit EN 12004.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso, bojë, materiale të lira etj. Rekomandohet njomja e sipërfaqes përpara përdorimit.

2. Përdorimi

ISOMAT AK-LIGHT hidhet gradualisht në ujë duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një masë uniforme në trajtë brumi. Për përzierjen rekomandohet përdorimi i një mikseri me xhiro të ulëta. Përzierja duhet të lihet rreth 10 minuta të stabilizohet dhe pastaj duhet të trazohet përsëri me ngadalë. Kola e pllakave duhet të shpërndahet ("e krehur") mbi sipërfaqe duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar (krehër), me qëllim që të aplikohet në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Pllakat duhet të fiksohen duke u ngjeshur në pozicionin e dëshiruar.

ISOMAT AK-LIGHT



Përzierja e përdorur duhet të mbulohet me pllaka brenda 30 minutash me qëllim që të evitohet formimi i "cipës", d.m.th. përpara se shtresa e ngjitëses të fillojë të mpikset.

Konsumi

1,0-3,0 kg/m², në varësi të madhësisë së dhëmbëve të mallës dhe të natyrës së nënshtresës.

Ambalazhimi

ISOMAT AK-LIGHT ofrohet në thasë letre 18 kg.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata, është minimumi 12 muaj.

Shënime

- ISOMAT AK-LIGHT përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Sipërfaqet shumë poroze, si p.sh betoni i lehtë, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj. duhet të lyhen fillimisht me astarin akrilik UNI-PRIMER.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.



08

ISOMAT S.A.
17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios,
Greece

EN 12004

Kolë prej çimentoje e deformueshme, e përmirësuar, për shtrimin e pllakave, me kohë të madhe të mbajtjes hapur dhe me rrëshqitje të reduktuar

- Reagimi ndaj zjarrit	Klasi E
- Forca ngjitëse fillestare në tërheqje	≥ 1 N/mm ²
- Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas (veprimit ose vjetrimin) termik	≥ 1 N/mm ²
- Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas ngopjes me ujë	≥ 1 N/mm ²
- Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas cikleve të ngrirjes-shkrirjes	≥ 1 N/mm ²

ISOMAT S.A.
BUILDING CHEMICALS AND MORTARS
ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:
17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475
www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dalta nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

